



# REPUBLIKA E SHQIPERISE

## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KZAZ Nr\_\_ QARKU\_\_\_\_\_

### PROCESVERBAL KONSTATIMI

ZGJEDHJET  
për Kuvënd të  
datës  
28 qershor 2009

#### KONTAKT ME KQZ

Sekretari i KQZ  
04 2235 362  
Posta elektronike:  
infosec@cec.org.al

-----  
Drejtorja e Komisioneve  
Zgjedhore

04 2274717  
Posta elektronike:  
commission@cec.org.al

-----  
Drejtorja e Logjistikes  
04 2274715  
Posta elektronike:  
logistic@cec.org.al  
-----



## **SQARIME**

### **MBI MËNYRËN E PËRDORIMIT TË PROCESVERBALIT TË KONSTATIMIT**

1. Procesverbali i Konstatimit mbahet nga Sekretari i KZAZ-së. Sekretari i KZAZ-së shënon parregullsitë që konstatohen sipas vendimeve të marra nga KZAZ-ja.
2. Të gjithë anëtarët e KZAZ-së janë të detyruar të firmosin në fund të çdo faqeje të Procesverbalit të Konstatimit. Sekretari vendos vulën e KZAZ-së në përfundim të konstatimeve për një qendër votimi (gjatë procesit të marrjes në dorëzim dhe gjatë procesit të numërimit të votave).
3. Procesverbali i konstatimit është dokumenti në të cilin shënohen të gjitha parregullsitë e konstatuara gjatë:
  - procesit të marrjes në dorëzim të kutive të votimit nga KQV-ja në KZAZ
  - procesit të numërimit të votave
4. Gjatë marrjes në dorëzim, parregullsitë e konstatuara lidhen me:
  - mospërputhjen e numrave të kodeve të sigurisë që janë të vendosura në 2 kutitë e dorëzuara *me numrat e shënuara në procesverbalin që tregon vulat që i janë dhënë për t`u përdorur kësaj qendre votimi;*
  - mungesën ose këputjen e një ose më shumë vulave me kode sigurie;
  - vendosjen e vulave me kode sigurie në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
  - ekzistencën e thyerjeve ose çarjeve në trupin ose në kapakun e kutive, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit; ose
  - ndryshimin e llojit, formës ose përmasave të kutive të ndryshme nga ato të përcaktuara nga KQZ-ja;
5. Gjatë numërimit të votave parregullsitë e konstatuara lidhen me:
  - ekzistencën ose jo në kutinë e materialeve zgjedhore të:
    - zarfi me FLETËT E VOTIMIT TË PAPËRDORURA së bashku me kundërfletët;
    - zarfi me FLETËT E VOTIMIT TË DËMTUARA;
    - lista e zgjedhësve, së bashku me regjistrin e posaçëm të zgjedhësve;
    - origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;
    - vula e KQV-së;
    - vula e kryetarit të KQV-së;
    - vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
    - vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, nëse ka; dhe
    - Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;
  - mospërputhjen e vulës së kryetarit të KQV-së me modelin krahasues;
  - mospërputhjen e numrit të gjetur të fletëve të votimit të papërdorura me atë që është shënuar në *Procesverbalin për Mbylljen e Votimit.*
  - mospërputhjen e numrit të gjetur të fletëve të votimit të dëmtuara me atë që është shënuar në *Procesverbalin për Mbylljen e Votimit.*
  - mospërputhjen e numrit të zgjedhësit që kanë votuar sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve dhe në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve, me atë që është shënuar në *Procesverbalin për Mbylljen e Votimit.*
  - mospërputhjen e numrit të llogaritur të fletëve të votimit të përdorura me atë që është shënuar në *Procesverbalin për Mbylljen e Votimit.*
  - ekzistencën ose jo në kutinë e votimit të:
    - fletëve të votimit
    - zarfit me Procesverbalin e Vulosjes,
  - mospërputhjen e numrit të fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit me shifrën që del nga diferenca e numrit të fletëve të votimit të përdorura me numrin e fletëve të votimit të dëmtuara.

[www.cec.org.al](http://www.cec.org.al)